



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2019:275948

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811287

KA.nr.187/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Yess Pharma” me seli në Prishtinë, me përfaqësues sipas autorizimit nga Agron Selimaj avokat, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit PSH.Nr.672-674/18 të datës 22.012019, jashtë seancës me datë 31.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit NPT “Yess Pharma” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.Nr.672-674/18 të datës 22.012019.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi NPT “Yess Pharma” me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.Nr.672-674/18 të datës 22.01.2019.

Gjykata me datë 18.01.2024 caktoi dhe mbajti seance publike të shqyrtimit kryesor, me pjesëmarrje të Av.Agron Selimaj sipas autorizimit të datës 30.08.2023 dhe të përfaqësueses së të paditurës Erëlehta Popaj, me autorizim të datës 21.07.2023, në këtë seancë u administruar provat e propozuara dhe aprovua propozimi i përfaqësuesit të paditësit që të merret prova me ekspertize financiare që të llogaritet dëmi nga data e njoftimit për dhënie të kontratës dhe atë për LOT-ot 6,10,11, si pasoje e vendimit të kundërshtuar.

Pas pranimit të ekspertizës financiare të datës 26.03.2024, përfaqësuesi i paditësit me parashtrësë të datës 30.05.2024 e ka njoftuar gjykatën se pas vlerësimit të konstatimit të ekspertit se paditësit nuk i është shkaktuar dëmi i pretenduar tërhiqet nga padia.

Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit për tërheqje të padisë, konform nenit 261 par 1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm  
Ka.nr.187/22, datë 31.05.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.